



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" I VLORËS

Nr. 407/3 Prot.  
Datë 18 . 04 .2022



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Nr. 127 Prot.  
Datë 19 . 04 .2022

#### ANEKSI NR. 1

#### I MARRËVESHJES STANDARD TË BASHKËPUNIMIT

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "*Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 3, pika 4 gërma "c, neni 64 pika 2 ndërmjet Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" dhe Kolegjit Universitar "Reald" Vlorë, (të quajtura Palë), më datën 25.05.2018 është nënshkruar Marrëveshja Standard për bashkëpunim të ndërsjelltë ndëruniversitar.

Marrëveshja Standard është protokolluar në Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali" me Nr. 665/2 Prot. datë 09.05.2018, dhe në Kolegjin Universitar "Reald" me Nr. 93 Prot., datë 25.05.2018.

Me qëllim thjeshtësimin e procedurave për rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërinstitutional hartohet ky Aneks me përcaktime si më poshtë:

##### Neni 1

Palët caktojnë respektivisht zv.rektorët për Kërkimin Shkencor, si personat ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve dhe/ose programeve specifike.

##### Neni 2

Palët pranojnë angazhimin e stafit akademik të tyre me kohë të pjesshme në programet e studimit të institucioneve respektive, pa qenë nevoja e marrjes së lejes nga çdo punonjës. Ky aneks nënkupton që leja e angazhimit me kohë të pjesshme konsiderohet e miratuar.

##### Neni 3

Angazhimi me kohë të pjesshme nuk duhet të cenojë punën administrative, akademike dhe kërkimore shkencore të stafit të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës.





UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" I VLORËS



KOLEGJI UNIVERSITAR "REALD"

Neni 4

Ky Aneks bëhet pjesë integrale e Marrëveshjes Standard dhe qëndron në fuqi 5 (pesë) vite nga data e nënshkrimit.

Neni 5

Ky Aneks gjen zbatim me nënshkrimin nga përfaqësuesit respektivë ligjor të të dy institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 6

Ku Aneks është hartuar në 2 (dy) ekzemplarë, nga një kopje për secilën prej Palëve.

Nënshkruar në Vlorë më 19.04.2022

Prof. Dr. Roland ZISI

Rektor

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

Prof. Dr. Spiro CAUSHI

Rektor

Kolegji Universitar "Reald"

